



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 973/20

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina-Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së AK-“Policia e Kosovës” nr. **973/20**, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE: “2-TECH” SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e Pikave të Antenave”, me nr.prok: 214-20-4618-2-2-1, më: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues- “Policia e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE: “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, lidhure me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e Pikave të Antenave”, me nr.prok: 214-20-4618-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Policia e Kosovës”.

II. DISKUALIFIKOHET, OE “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, me Numri unik identifikues: **810816027**, Numri të biznesit : **70833379**, lidhure me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e Pikave të Antenave”, me nr.prok: 214-20-4618-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Policia e Kosovës”, sepse i njëjti ka ofertuar me dokumente të falsifikuara, duke e ofruar vërtetimin e ATK-së të falsifikuar. Andaj duke u bazuar në nenin 99 pika 2 të LPP-së Operatori në fjalë diskualifikohet dhe atë për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve, të njëjtit i ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës, nga dt. **22.01.2021** deri me dt. **21.07.2021**.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues-“Policia e Kosovës”, me datën 24.11. 2020, ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së ndaj OE: “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë.

Me dt. 26.11.2020, eksperti shqyrtues ka pranuar autorizimin lidhur me përgatitjen e një kronologjie lidhur me kërkesën AK- "KK-Prizren", të datës 30.11. 2020 ku ka sqaruar:

Autoriteti kontraktues- Policia e Kosovës me datë 24 nëntor 2020 ka parashtruar kërkesë në OSHP për të aplikuar dispozitat e nenit 99 pika 2 të LPP-së ndaj OE: "2 TECH"SH.P.K-Prishtinë, Titulli: "Mirëmbajtja e Pikave të Antenave", me numër të prok: 214-20-4618-2-2-1, numri unik identifikues nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një vjeçare.

Me datë 17.11.2022, OE në fjalë i është dërguar një e-mail ku i janë kërkuar dokumentet si Vërtetimet e lëshuara nga Gjykata dhe Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore (ATK), sipas kërkesës në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, po në datë është pranuar përgjigja nga OE që konfirmon pranimin e e-mailit. Ndërsa me datë 19.11.2020 OE i ka sjellë në mënyrë fizike vërtetimet e kërkuara sipas emailit të datë 17.11.2020, pas pranimin të këtyre vërtetimeve është bërë dhe rishikimi i tyre, pas rishikimit të këtyre vërtetimeve më saktësisht vërtetimi Tatimor i sjellë nga Operatori Ekonomik me nr. serik:1000749089 i datës 13.11.2020 u vërtetua se ky vërtetim i lëshuara nga ATK është për një person fizik me emrin Laureta Behluli që ka për destinim aplikimin për bursë, ku kjo është vërtetuar në faqen e ATK-së. Mbi këtë bazë OE ka tentuar të bëjë mashtrim të AK duke falsifikuar vërtetimin e ATK-së.

Autoriteti Kontraktues Zyra e Prokurimit-Policia e Kosovës me datë 17.11.2020 ka kërkuar nga OE që të sjellë vërtetimet në afat prej 5 ditëve nga marrja e këtij emaili për tenderin "Mirëmbajtja e Pikave të Antenave", me nr. të prok:214-20-4618-2-2-1.

1.Vërtetimin nga Administrata Tatimore e vendit të tyre të themelimit, se nuk janë të vonuar për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. 1. Vërtetimin nga Gjykata Themelore –Departamenti për Çështje Ekonomike-Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbushë Kërkesat e Përshtatshmërisë, të jetë së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës-origjinali/kopje e noterizuar. 3. Vërtetimin nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxherët e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një Gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet të ngjashme, Vërtetimin nga Gjykata themelore-origjinal/kopje të noterizuar. 4. Sigurimin e tenderit-origjinalin.

Autoriteti kontraktues ka bashkangjitur këto dokumente krahas kërkesës:

- Raportin e vlerësimit,

- Komunikimet me email ,
- Vërtetimin e sjellë nga Operatori Ekonomik,
- Vërtetimin që figuron në ATK etj,

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj një operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuara, në këtë është vërtetuar për një gjë të tillë , ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në të cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar apo të ngjashme nga ana e operatorëve ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 24.11.2020 përmes emailit zyrtar ka kërkuar nga Operatori Ekonomik: "2-TECH" SH.P.K. –Prishtinë përgjigje lidhur me kërkesën e AK "Policia e Kosovës" për Diskualifikim.

Operatori Ekonomik me datën 25.11.2020 përmes emailit ka njoftuar OSHP-në duke e dërguar në attach Vërtetimin Tatimor të Lëshuar nga ATK , Provat për Gjendjen Financiare të Lëshuar nga ATK si dhe Deklaratën nga Kontabilisti z. Bujar Hoxha në të cilën Sqaron: Deklaratë nga kompania 2-Tech shpk më është kërkuar një vërtetim tatimor nga ATK për nevojat e pjesëmarrjes në Tender. Në softwerin që përdori unë për menaxhimin e shumë kompanive gjenerova një vërtetim Tatimor i cili paska pasur një gabim teknik, unë si kontabilist i kompanisë në fjalë garantoj me përgjegjësi të plotë se kompania 2-Tech shpk nuk ka obligime tatimore gjë që jua dëshmojmë me vërtetim tatimor të marruar nga ATK me datën 24.11.2020 si dhe gjendjen e dt 24.11.2020 si dhe gjendjen e përgjithshme për komplet vitet që dëshmon se nuk kanë Obligime të mbetura Duke qenë i njoftuar nga personeli i kompanisë 2-Tech shpk për vendimin tuaj lidhur me tenderin Mirëmbajtja e Pikave të Antenave unë Bujar Hoxha me Nr.Personal:1013063628 si i punësuar kontabilist pranë kompanisë 2-Tech shpk deklaroj që ka ndodhur një lëshim Teknik nga ana ime personale në lidhje me deklaratën për borxhin ndaj ATK-së dhe se Kompania nuk ka pasur asnjë njohuri për lëshimin që ka ndodhur.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konformë nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: kërkesa e AK-së e datës: 24.11.2020, raporti kronologjik i ekspertit shqyrtues i datës: 30.11.2020 dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se me datë 17.11.2020 AK ka kërkuar nga OE "2-TECH" Sh.p.k të dorëzojë vërtetimin tatimor e lëshuar nga ATK dhe vërtetimin e lëshuar nga Gjykata, si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kriterit të pranueshmërisë sipas dosjes së tenderit. Me datë 19.11.2020 OE ankues i ka dërgua në mënyrë fizike vërtetimet e kërkuara. Më pas AK ka bërë verifikimin e vërtetimit tatimor të ATK-së sipas numrit serik ku pas verifikimit rezulton se vërtetimi me këtë numër është lëshuar për një person fizik dhe AK ka diskualifikuar OE ankues ka aktiviteti i prokurimit. OE ankues me datë 30.11.2020 si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së ku së bashku me ankesën ka prezantuar edhe vërtetimin tatimor të datës 24.11.2020. OSHP me datë 21.12.2020 ka nxjerr vendim ku e ka aprovuar pjesërisht ankesën e OE ankues dhe ka kërkuar nga AK që të kërkojë informacioni shtesë nga ATK se si mund të ndodhë një mospërputhje e tillë në vërtetimin tatimor. Bazuar në vendimin e OSHP-së, AK me datë 21.12.2020 ka kërkuar nga ATK informacione lidhur me vërtetimin tatimor të dorëzuar nga OE me numër serik 1000749089 të datës 13.11.2020. ATK me datë 24.12.2020 përmes emailit është përgjigjur se bazuar në verifikimin e vërtetësisë së dokumentit të dorëzuar nga OE ankues, rezulton se dokumenti është i falsifikuar. Bazuar në këtë informacion nga ATK, AK me datë 31.12.2020 ka nxjerrë vendimin ku e ka eliminuar OE ankues. Më tej OE ankues me datë 31.12.2020 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Përderisa AK në të njëjtën ditë ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Sipas shkresave të lëndës në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, rrjedha e të cilit është paraqitur si më sipër sqarojmë se OE ankues ka dorëzuar vërtetimin tatimor bashkë me ankesë si provë 2, e sipas të cilit bazuar në verifikimin online në ATK del se OE ankues nuk ka obligim tatimor. Megjithatë, përkundër që OE ankues ka prezantuar deklaratën e kontabilistit si provë 1 duke theksuar se është bërë gabim teknik, bazuar në sqarimin e organit kompetent për lëshimin e një dokumenti të tillë, pra ATK-së, rezulton se është bërë falsifikim i vërtetimit tatimor. Pra ATK e ka cilësuar si falsifikim duke marrë për bazë verifikim teknik të njësive të TI-së se nuk mund të ndodhë që një dokument të ketë numrin serik të një vërtetimi tjetër. Këtë dokument OE ankues e ka prezantuar si dëshmi për përmbushjen e kriterit të provueshmërisë së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se OE tek AK ka dorëzuar VERTETIMIN e ATK-së me numër 1000749089, të datës 13.11.2020, me përshkrimin si ne vijim: Arsyeja e Aplikimit :për tender dhe përshkrimin tjetër se personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pa shlyera apo obligime tjera tatimore.

Ndërsa pas verifikimit nga Paneli shqyrtues në saidin <https://evertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer>, tek rubrika kërko vërtetimin tatimore duke e shtypur numrin e vërtetimit të ATK-së 1000749089, (vërtetimi ky i dorëzuar nga ana e OE në fjalë tek autoriteti kontraktues) ka rezultuar kjo gjendje lidhur me këtë vërtetim të ATK-së :

Kërko Vërtetimin Tatimor

Numri Serik: 1000749089

Numri Personal: 1247854521

Emri dhe mbiemri: Lauda Selimi

Komuna: Ferizaj

Data: 13/11/2020

Arsyeja e kërimit: Për Bursë

Gjendja tatimore: ATK nuk ka shënim për personin. TAX has no record of this person. PAK nema podatke za lice.

Vërtetimi: Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e kërimit. The verification is valid for 90 days from the day it is issued. Potvrda važi 90 dana od dana kada je izdata.

© 2021 - Administrata Tatimore e Kosovës

Andaj nga te cekurat si me lart paneli shqyrtues vjen në përfundim se Vërtetimi i ATK-së, i ofruar nga OE, “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, me numër fiskal 810816027, i datës 13.11.2020, është i falsifikuar, dhe për këtë veprim të kundërligjshëm të bere nga ana e OE “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, OSHP ndërmer masa në pajtim me nenin 99 të LPP-se .

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se duke pasur parasysh faktin se AK përmes ATK-se ka vërtetuar dhe sqaruar, se vërtetimi i ofruar nga OE “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, i datës 13.11.2020 dhe me kodin UNIREF 1000749089, nuk i përket fare OE në fjalë, ashtu siç është sqaruar edhe me lart konstatojmë se vërtetimi i ofruar nga OE në fjalë është i falsifikuar .

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e Pikave të Antenave”, me nr. prok: 214-20-4618-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës, OE 2-TECH” SH.P.K. –Prishtinë, ka ofertuar me dokumente te falsifikuara ndaj të njëjtëve OE merren masa në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së . Pra për veprimet e kundërligjshme te OE “2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë, paneli shqyrtues konstaton se ndaj te njëjtëve merren masa në pajtim me nenin 99 të LPP-së, duke e diskualifikuar nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit në një periudhë prej gjashtë muajve (6 muajve) .

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –“Policia e Kosovës”,
- 1x1 OE:“2-TECH” SH.P.K. -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.